



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“ISP BROADCAST” SH.P.K.

Numri i biznesit – 810011643

Pronar– Qëndrim KRYEZIU

OSHMA “ISP POPULLORE”

Rr/24 Maji, nr. 46-1

Prishtinë



VENDIM

për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Adiovizuale “ISP Popullore” për transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes – me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Adiovizuale KPM-2017/02, ka hyrë në fuqi më 25 janar 2017, ndërsa, me Kreun III të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Adiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Më datën 29 mars 2021, kandidati “ISP Popullore”, ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes, me përmbajtje tematike.

Arsyetimi

4. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së OSHMA “ISP Popullore”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Kreun III të Rregullores KPM-2017/02.

5. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “ISP Popullore” ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
6. Sipas Nenit 21, paragrafit 5 të Rregullores KPM-2017/02, kandidati për licencë të KPM-së “ISP Popullore”, duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
7. Komisioni vlerëson se, kandidati “ISP Popullore” ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, në pajtim të plotë me Rregulloren e KPM-së KPM-2017/02.

Vendim

8. Komisioni në takimin e tij të mbajtur me datën 16 prill 2021, merr vendim që kandidatit “ISP Popullore” me seli në Prishtinë, t’i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
9. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



16.04.2021

datë